




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/1509/18</u>
Dep.	Prot. No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>28-05-2018</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.05.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-835/18, për zyrtarin z.Enver Hyseni, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-03-02-835/18, që për trajtim ka pasur zyrtarin z.Enver Hyseni, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, ka filluar të shqyrtohet pas kërkesës së dërguar në AKK-ë nga një palë e tretë, me arsyetimin që të trajtohet zyrtari z.Enver Hyseni, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, pasi që i njëjti figuron si person i autorizuar në biznesin privat.

Agjencia Kundër Korrupsionit, sipas procedurës ka analizuar informatën e dërguar dhe ka vërejtur se z.Enver Hyseni, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës figuron si person i autorizuar në biznesin privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.



Pas kësaj shkrese z. Enver Hyseni, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Ne takimin e organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z.Enver Hyseni, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar.

z.Enver Hyseni, pasi ka dëgjuar faktet e prezantuara, ka deklaruar se nuk ka kurrfarë interesi me biznesin të cilin është përmendur, nuk e ka përfaqësuar apo nuk ka asnjë lloj aksioni në këtë biznes, dhe është i habitur si ka mundësi që të jetë person i autorizuar i këtij biznesi pasi që nuk ka qen i informuar për këtë çështje asnjë herë, por është arsyetuar se pronarin e këtij biznesi e njëh edhe pse nuk ka kontakte me të, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë përpjekje të kontaktoj dhe të marr arsyetimet se si ka ndodhur që aje të jetë person i autorizuar i këtij biznesi, dhe do të kërkojë që të bëjë ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas kësaj shkrese nga z.Enver Hyseni, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se Enver Hyseni, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin privat me emër N.T.P-“Euro-Geti.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z.Enver Hyseni, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, duke bërë ndryshimet e parapara, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar në një biznes privat janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

